



# **RREGULLORE PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS**



Në bazë të pikës 6.5 të Statutit të Federatës së Sportit Shkollor, Bordi i FSSHRK-së, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2022, mori vendim për miratimin e rregullores së Këshillit Mbikqyrës për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta:

## **RREGULLORE**

### **PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS**

#### **Dispozitat themelore**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Mbikqyrës.

##### **Neni 2**

Përbërja, kompetencat dhe fusha e veprimit të Këshillit rregullohen me Statutin e FSSHRK-së dhe më Rregulloren e Bordit.

##### **Neni 3**

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë nga radhët e delegatëve të autorizuar të kuvendit.

##### **Neni 4**

Mandati i Anëtarit të Këshillit zgjatë katër vjet, prej momentit të emërimit të ti nga Kuvendi.

##### **Neni 5**

Këshilli Mbikqyrës në fushë veprimin e vetë kryen keto punë:

- Kuvendi dhe Bordi dhe të gjithë trupat punues të tij janë të obliguar që Këshillit Mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës dhe statutit të tyre.
- Këshilli Mbikëqyrës përcjellë ligjshmërinë e punës së bordit dhe trupave punuese ndërmjet dy kuvendeve dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Federatës
- Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet i raporton Kuvendit të Federatës.



## FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR

### **Neni 6**

Anëtarët e Këshillit duhet të punojn pa presione, dhe ti respektojnë vendimet e statutit të Federatës së Sportit Shkollor si dhe rregullat që janë në fuqi të hartura nga Kuvendi dhe Bordi i saj.

### **Neni 7**

Anëtarët e Këshilli për punën e vetë i përgjigjen Kuvendit dhe për mos funksionalitet e tij.

## **MËNYRA E VENDOSJES**

### **Neni 8**

Votimi në mbledhje është i hapur. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës duhet të votojnë “PËR”, pastaj “KUNDËR” Së pari thirren të votojnë ata që janë “PËR”, pas tyre ata që janë “KUNDËR”.

### **Neni 9**

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj.

### **Neni 10**

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Kuvendi

Prishtinë

13.10.2022

Kryetari i FSSHRK-së

Adrian Telaku prof.